



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta -**  
**Ministry of Culture, Youth & Sports**

/Departamenti i Trashëgimisë Kulturore/Departaman za Kulturno Nasledje/  
/Cultural Heritage Department/

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENCË:</b>	05/2016				
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kujtim Shala, Ministër				
<b>CC:</b>	Divizionet e DTK-së Institucionet vartëse				
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	z. Veton Firzi, Sekretar i Përgjithshëm <i>Veton Firzi</i>				
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Vjollca Aliu, udhëheqëse <i>Vjollca Aliu</i>				
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Dokumenti i Politikave Programore				
<b>Nr. i zyrës:</b>	012	<b>Lokacioni:</b>	22557	<b>Data:</b>	18/01/2016
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>		<b>Datum:</b>	
<b>Room No.:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					X
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>					

Faqe 1 nga 2

I nderuar z. Ministër,

Bashkangjitur ju dërgoj për miratim Dokumentin e Politikave Programore për vitin 2016.

Me respekt.

Faqe 2 nga 2

# **Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore**

## ***Politikat e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, MKRS***

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon ta mbrojë, ruajë dhe promovojë trashëgiminë kulturore të Kosovës, ashtu si e kërkojnë konventat ndërkombëtare dhe standardet evropiane dhe ashtu si i takon një vendi evropian.

Trashëgimia Kulturore e Kosovës është pjesë e rëndësishme e integritetit të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Secili qytetar i Kosovës dhe secili qytetar prezent në Kosovë ka të drejtë ta gëzojë dhe detyrë ta ruajë trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Qasja jonë ndaj trashëgimisë kulturore është ligjore dhe profesionale. Trashëgimia kulturore e Kosovës është e Kosovës, vlerë e popullit të saj. Trashëgimia kulturore dhe kultura në përgjithësi janë themele të humanitetit dhe si të tilla duhet të trajtohen gjithnjë dhe kudo.

Ne synojmë ta trajtojmë trashëgiminë kulturore të Kosovës me politika afatgjate dhe për këtë jemi duke përpiluar edhe Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore e cila është strategji 10 vjeçare.

Ky dokument përmban politikat programore të Departamentit të Trashëgimisë Kulturore të bazuara në Planin e Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Gjatë vitit 2015 kemi mbajtur takime të shumëta me institucionet vartëse dhe jemi njohur me punën e tyre konkrete gjatë vizitave tona.

Politikat kulturore për vitin 2016 bazohen në studimin e nevojave të identifikuara të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe në politikat tona kulturore për të përmbushur programin qeveritar.

Punë të mbarë!

Kujtim Shala

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

## **Politikat e trashëgimisë kulturore 2016**

Duke pasur parasysh historinë e zhvillimeve në trashëgimi kulturore, kërkesat, nevojat, potencialin dhe gjendjen ekzistuese të institucioneve vartëse të Ministrisë dhe gjendjen e përgjithshme, ne kemi kërkuar buxhet shtesë për trashëgiminë kulturore, duke aritur 20% rritje të buxhetit në vitin 2016. Buxheti i përgjithshëm i MKRS-së për trashëgiminë kulturore është:

**Investime kapitale: 1,377.000 €** (një milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë euro)

**Subvencione: 517.286 €** (pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë euro)

Buxheti efikas mundëson realizimin e politikave kulturore për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Gjatë vitit 2016 ne do t'i realizojmë politikat kulturore të përcjella edhe me plane konkrete të veprimit nga institucionet vartëse që realizojnë politikat kulturore të MKRS-së për trashëgiminë kulturore.

Në kuadër të këtij dokumenti përfshihen këto tri politika programore:

1. Mbrojtja dhe ruajtja
2. Kërkimet dhe botimet
3. Promovimi

### **1.Mbrojtja dhe ruajtja**

#### **1.1.Avansimi i legjislationit**

Pa avancimin e legjislationit nuk mund të krijojmë kushte të duhura për zhvillimin e sektorit të trashëgimisë kulturore. Po ashtu, avancimi i ligjit mundëson zhvillimin e qëndrueshëm, menaxhimin e integruar të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore por edhe hisedarëve tjerë në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

#### **1.2.Përmirësimi i kornizës institucionale dhe bashkëpunimi institucional**

Për t'u zbatuar ligji dhe për t'u avancuar sistemi për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore duhet të përmirësohet edhe gjendja e përgjithshme e institucioneve vartëse të trashëgimisë kulturore. Gjatë vitit 2016 do të investohet në mekanizmat qeverisës për zhvillim të qëndrueshëm, në menaxhim të projekteve efektive për përmirësimin e gjendjes, në buxhetim efikas dhe në sistemin e menaxhimit, monitorimit dhe performancës së institucioneve

varhtëse. Definimi i statutit të institucioneve publike të trashëgimisë kulturore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre qartëson sistemin e punës dhe mundëson menaxhim efikas. Po ashtu vetëfinancimi, gjenerimi i të ardhurave dhe bashkëfinancimi janë do të jetë prioritet për projektet e institucioneve varhtëse.

Aktivitetet që do të ndërmerren:

- Miratimi i projektligjit për trashëgimi kulturore;
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit për muze;
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore;
- Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2016- 2026;
- Mandatet e institucioneve dhe përmirësimi i kornizës institucionale
- Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të punonjësve
- Bashkëpunimi mes institucioneve të trashëgimisë në projekte të përbashkëta dhe bashkëpunimi ndërinstytucional dhe me partnerë ndërkombëtarë (sidomos me institucione edukative)
- Hartimi dhe zhvillimi i politikave të vetëfinancimit, gjenerimit të fondeve dhe bashkëfinancimit.
- Aktivitetet në kuadër të inventarizimit.

## **2.Kërkimet dhe botimet**

### **2.1.Gërmimet arkeologjike**

Gërmimet arkeologjike janë aspekt i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore dhe promovimit të një qytetërimi të hershëm në Kosovë. Fokus të veçantë do të ketë në hapjen e parkut arkeologjik të Ulpianës si ikonë e trashëgimisë arkeologjike të Kosovës por edhe të lokaliteteve tjera. Gërmimet arkeologjike do të bëhen sipas planeve të hollësishme. Secili gërmim arkeologjik i bërë në Kosovë duhet të planifikohet dhe të interpretohet ose të bëhet i qasshëm për interpretim në bazë të legjislacionit.

### **2.2 Konservim-restaurim**

Projektet e konservimit-restaurimit paraqesin dokumentacionin teknik dhe shkencor në përputhje me standardet bashkëkohore. Të njëjtat do të përmbliidhen në inventarin e trashëgimisë kulturore. Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore do të bëhet sipas planeve paraprake. Kalatë, kullat dhe shtëpitë e objektet tjera me vlera autentike do të kenë priorite.

### **2.3.Kërkimet dhe botimet në fushën e trashëgimisë kulturore**

Gjatë këtij vitit do të ketë hulumtime, studime dhe botime për trashëgiminë kulturore me theks të veçantë në kategorinë e trashëgiminë arkeologjike, arkitektonike, trashëgiminë shpirtërore dhe atë natyrore. Studimet dhe botimet e institucioneve të trashëgimisë kulturore do të planifikohen nga vetë institucionet. Fokus të veçantë do të ketë te revistat, monografitë dhe sutimet interpretive multidisiplinare.

Aktivitetet që do të ndërmerren:

- Gërmimet arkeologjike;
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve të konservimit-restaurimit;
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve, planeve të menaxhimit si dhe përcaktimi i kufijëve të qendrave historike.
- Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore
- Studimet interpretive multidisiplinare të trashëgimisë kulturore, të brendshme por edhe me bashkëpunim të jashtëm
- Botimet e këtyre studimeve

### **3. Promovimi**

Trashëgimia kulturore duhet të integrohet brenda fushës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit kulturor . Gjatë vitit 2016 do të fokusohemi në promovimin e zhvillimit të turizmit kulturor. Po ashtu do të jetë në fokus edhe promovimi i Konventës së Faro-së për vleresimin e trashëgimisë kulturore si vlerë e përbashkët për gjithë shoqërinë.

Aktivitetet që do të ndërmerren:

- Promovimi i botimeve të institucioneve vartëse;
- Ekspozita e përherëshme në Muze të Kosovës dhe ekspozitat tjera të përherëshme dhe të përkohëshme
- Promovime në kuadër të ditëve të ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe konferenca ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore.
- Promovimi i turizmit kulturor përmes konferencave dhe botimeve të materialeve promovuese, aktiviteteve kulturore të organizuara nga QRTK-të
- Bashkpunimi me institucione tjera relavenate për promovimin e turizmit kulturor

ANEKS I. Investimet kapitale

**1. Kalaja e Prizrenit**

Buxheti: 100.000 euro

**2.Lokalieti Ulpiana**

Buxheti 100.000 euro

**3.Lokalieti Dersnik**

Buxheti 100.000 euro

**4. Kalaja e Harilaqit**

Buxheti 40.000 euro

**5.Kalaja e Dardanës**

Buxheti 30.000 euro

**6. Kalaja e Novobërdes**

Buxheti 100.000 euro

**6.Gërmimet arkeologjike me karakter shpëtimi**

Buxheti 50.000 euro

**7. Masat preventive-intervenimet emergjente**

Buxheti 200.000 euro

**8. Renovimi i Ndërtesës së Muzeut të Kosovës**

Buxheti 277.000 euro

**10.Konservimi-restaurimi i Shtëpise së Mahmut Agë Gjinolli në Vushtrri**

Buxheti 70.000 euro

**11.Konservimi-restaurimi i Shtëpisë së Xhafer Devës**

Buxheti 100.000 euro

**12.Studimi i fizibilitetit për Muzeun e Natyrës**

Buxheti 50.000 euro

**13.Përfundimi i punimeve në Kishat Ortodokse**

Buxheti 120.000 euro

**14. Shkolla e parë shqipe në Stubëll**

Buxheti 25.000 euro

**15.Kulla e Nuhi Berishes, Kamenicë**

Buxheti 15.000 euro

*Shënim:* Të gjitha investimet kapitale do të bëhen në bazë të planeve të hollësishme dhe legjislacionit në fuqi.



## ANEKS II. Subvencionet

### **1. Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve**

Buxheti 75.000 euro

### **2. Instituti Arkeologjik i Kosovës**

Buxheti 100.000 euro

### **3. Muzeu i Kosovës**

Buxheti 90.000 euro (75.000 euro + 15.000 euro obligime të bartura nga viti 2015)

*Shënim:* Planprojektet e institucioneve të lartëshënuara do të bëhen në përputhje me politikat programore të trashëgimisë dhe buxhetit të alokuar si më sipër. Në përputhje me nenin 4, pika 1 të Rregullores Nr.09/2015 për Subvencionimin në fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit, planet e hollësishme të punës së institucioneve vartëse do të miratohen nga Këshillat Drejtuese të atyre institucioneve. Pas dorëzimit të këtyre planeve të hollësishme të institucioneve do të alokohet buxheti specifik për to.

### **1. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Prishtinë**

Buxheti 25.000 euro

### **2. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore , Pejë**

Buxheti 30.000 euro

### **3. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore , Prizren**

Buxheti 35.000 euro

### **4. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore , Mitrovica**

Buxheti 25.000 euro

### **5. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore , Gjilan**

Buxheti 25.000 euro

### **6. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore , Gjakovë**

Buxheti 20.000 euro

*Shënim:* Planprojektet e hollësishme të Qendrave Rajonale të Trashëgimisë Kulturore do të bëhen në përputhje me politikat programore të trashëgimisë dhe buxhetit të alokuar si më sipër dhe me kërkesat e qendrave përkatëse të cilat do të analizohen dhe aprovohen nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore. Planprojektet do të jetë të hollësishme dhe pas dorëzimit të tyre do të alokohet buxheti.

### **Departamenti i Trashëgimisë Kulturore**

Buxheti 92.286 euro

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore do të ketë në përgjegjësi të drejtëpërdrejtë edhe kordinimin e grupeve punuese për hartimin dhe plotësimin e legjislacionit, komisioneve të punës si dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet vartëse për promovimin e trashëgimisë kulturore. Departamenti i Trashëgimisë Kulturore do të bëjë po ashtu një planprojekt të hollësishëm për aktivitetet e saj.

### ANEKS III. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

#### **Monitorimi dhe raportimi**

Transparenca është esenciale për institucionet shtetërore. Secili institucion do të monitorojë, sipas legjislacionit në fuqi, veprimtarinë e vetë të miratuar në këtë dokument dhe sipas planeve të tyre të hollësishme. Monitorimet do të ketë edhe nga institucionet tjera brenda Ministrisë dhe jashtë saj, sipas mandatit të tyre ligjor.

Monitorimi i aktiviteteve të planit të punës mundëson raportim efikas. Secili institucion do të raportojë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore çdo 3 muaj dhe në fund të vitit për aktivitetet e realizimit të planit të tyre të punës. Format e raportimit mund të mirren nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore. Raportimi mundëson Ministrinë e Kulturë, Rinisë dhe Sportit që të raportojë në instancat tjera ligjore, sipas mandatit të tyre ligjor.


#### **Puna dhe vlerësimi**

Përmes monitorimit dhe raportimit do të bëhet edhe matja e punës së institucioneve vartëse të trashëgimisë kulturore dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përgjithësi.

**Miratuar me datë 18.01.2016**

**Veton FIRZI**  
  
**Sekretar i Përgjithshëm**



**Kujtim SHALA**  
  
**Ministër**